

DEKRET
Nr. 8289, datë 7.8.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR. 8288, DATË 7 GUSHT 2013 “PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 67 pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Ndryshimin e nenit 1 të dekretit nr. 8288, datë 7 gusht 2013 “Për mbledhjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, si më poshtë:

“Legjislatura e VIII e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbledhet ditën e hënë, datë 9 shtator 2013, ora 18:00.”

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani